



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:180486

Datë: 26.06.2024

Numri i dokumentit: 05859739

C.nr.51/2015

Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Binak Duqi dhe procesmbajtësen Fexhrije Sejdiu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Korporata Energetike e Kosovës nga Prishtina, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit nr.229 dt.21.06.2013, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh. A. (KEDS), në Prishtinë, sheshi “Bill Klinton”, nr.3, e të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj Jetullah Mehmeti nga Prishtina me autorizim, kundër të paditurit N... M... A... nga P..., Rruga “S...” pnr., te cilin e përfaqëson i autorizuari i tij avokati B... S.... nga P..., me objekt kontesti Kompensimin e dëmit material, me vlerë të kontestit: **4,827.52 €uro**, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur më datën 18.06.2024, në prani të palëve ndërgjyqëse të autorizuarit të paditëses dhe të autorizuarit të paditurit, ndërsa me datë 25.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.A. (KEDS), në Prishtinë, sheshi “Bill Klinton”, nr.3, **si e pabazuar**, me të cilën ka kërkuar që të:

“Aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh. A. (KEDS), në tërësi si e bazuar.

Obligohet i padituri që paditësit të i paguaj dëmin e shkaktuar material në shumë prej 4,827.52 €, dhe atë me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e këtij kontesti, të gjitha në afat prej 15 ditësh me kërcënimin e përmbarimit.”

II. Refuzohet kërkesa e palës se paditur lidhur me pagesën e shpenzimeve të procedurës që ato të paguhen sipas tarifës së OAK – së.

III. Secila palë në procedurë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja, nëpërmes të autorizuarit të saj ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia dhe të detyrohet i padituri që në emër të dëmit të shkaktuar material, paditëses t’ia paguajë shumën prej **4,827.52 €**, me kamatë ligjore nga dita e ushtrimit të padisë. Tutje ne padi shton se i padituri prej datës se pavërtetuar e deri me 13.12.2008 me qellim qe ti sjell vetit pasuri te kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike ne mënyrë te paautorizuar, ka montuar njehsor te ri nr. dhe ka

larguar dy urat e tensionit te ulet ne fazën L1 dhe L3 dhe energjia e shpenzuar nuk është regjistruar. Me veprimin e tij i padituri i ka shkaktuar paditësit dem material ne vlere prej **4, 827.52 €**.

Ndryshe ne seanca i autorizuari i paditëses ka shtuar se qëndrojmë pranë padisë dhe kërkesë padisë lidhur me dëmin e shkaktuar nga pala e paditur lidhur me keqpërdorimin e energjisë elektrike me këtë rast duke i shkaktuar dëm paditëses në shumë prej 4,827.52 €, sa i për këtë këtë dëmi pala paditëse të drejtën e vet e mbështetë edhe në ndjekjen e procedurës penale ku i padituri ka bërë keqpërdorimin e energjisë elektrike mirëpo për shkak të rrethanave nuk ka marrë dënimin e meritura për veprën penale andaj ne si palë paditëse kemi qenë të lidhur me kontestin penale po ashtu kemi ushtruar edhe padinë për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil. I propozoj gjykatës që pas administrimit të provave gjë që vërtetohet që i padituri ka keqë përdorë energjinë eklektike dhe i ka shkaktuar dëm paditëses konsiderojmë dhe propozojmë që padinë dhe kërkesë padinë ta aprovoi në tërësi si të bazuar dhe ta detyroi të paditurin që ta përmbushë këtë obligim ndaj paditëses. Sa i për këtë përgjigjes në padi të palës së paditur të njëjtën e kundërshtoi për faktin që ndaj të paditurit është zhvillua procedurë penale edhe pse nuk kemi vendim të formës së prerë në këtë rast nuk e justifikon të paditurin që i njëjti të lirohet nga përgjegjësia pasi që dëmi ekziston dhe është shkaktuar dhe dihet fajtori. Ndërsa ne fund shton se nga provat e administruar dhe që gjinden në shkresa të lëndës e posaçërisht nga provat e procedurës penale vërtetohet mjaftueshëm baza e kërkesë padisë për faktin që ndaj të paditurit është zhvillua kjo procedurë lidhur me keqë përdorimin e pa autorizuar e energjisë elektrike gjë që i ka shkaktuar dëm paditëses në shumën prej 4,827.52 €, në këtë rast i propozojmë gjykatës që të njëjtën ta aprovoi në tërësi ta obligoi të paditurit që ta kryej obligimin ndaj paditëses me kamatë ligjor nga ushtrimi i padisë e deri në pagesën definitive si dhe të paguaj taksën gjyqësore lidhur me ushtrimin e padisë në shumë prej 40€.

I ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I padituri përmes te autorizuarit te tij në përgjigje në padi te datës. 02.04.2024 e ka kontestuar kërkesëpadinë si për nga baza ashtu edhe nga lartësia për shkak te metave elementare te saj ngase e njëjta është e paqarte e pabazuar ne prova konkrete sidomos sa i përket legjitimitetit si ne aspektin objektiv edhe atë subjektiv, duke theksuar se e njëjta është e parashkruar për shkak te paraqitjes jashtë afatit te parapare ligjor kjo komform nenit 358 par 1 dhe 2 si dhe nenit 341 par 1 dhe 2 të LMD – së. Ndryshe ne seanca përfaqësuesi i autorizuar i paditurit ka deklaruar se: Lidhur me këtë çështje brenda afatit të përcaktuar respektivisht me dt. 02.04.2024 pranë kësaj gjykate kemi parashtruar përgjigje në padi me anë të së cilës e kemi kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesë padinë andaj mbesim në tërësi pranë të njëjtës dhe gjykatës i propozojmë të ketë parasysht bazën ligjore respektivisht nenin 14 të LPK-së po ashtu nenin 358, 341 dhe dispozitat tjera ligjor të LMD që kanë të bëjnë me parashkrimin e kërkesës e po ashtu neni 399 të LPK-së, duke konsideruar në rastin konkret nuk është vërtetua themelësia e kërkesë padis[. Sa i për këtë pretendimet e përfaqësuesit të paditëses për keqpërdorimin dhe vërtetimin e fajësisë kjo nuk çnderon nga se një gjë e tillë nuk është vërtetuar nga gjykata në procedurë penale me aktvendimin me të cilën thirret pala paditëse. Po ashtu në rastin konkret edhe provat bashkangjitur padisë janë jo kredi bilë dhe gjykata nuk duhet falë besimin sidomos sa i për këtë lartësisë së dëmit e cila është bërë njëanshëm nga paditësja dhe në mënyrë paushallë si dhe pa ndenje ekspertizë përkatëse, andaj gjykatës i propozojmë ta refuzoi padinë si të pa bazuar dhe obligohet pala paditëse për shpenzimet e procedurës sipas tarifës së OAK-së.

Ndërsa ne fund shton se ashtu sikurse edhe në fjalën hyrëse si dhe deklarimeve me anë të përgjigjes në padi konsiderojmë se në rastin konkret nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë themelësia e kërkesëpadisë dhe se e njëjta duhet refuzua. Lidhur me këtë çështje gjykatës i propozojmë të merr për bazë dispozitat ligjore të LMD-së dhe LPK-së sa i për këtë çështjes së parashkrimit e po ashtu duke marrë për bazë edhe faktin që në rastin konkrete dëmi i pretenduar

nuk është vërtetuar me as një provë bindëse dhe legjitime andaj mbesim edhe më tej në përgjigjes në padi dhe deklarimeve tjera dhe gjykatës i propozojmë që pas përfundimit të kësaj seance merr aktgjykim refuzohet në tërësi padia dhe kërkesë padia e paditëses KEK sh. A Prishtinë me shenjen C.nr. 51/2015 si e pa bazuar dhe obligohet paditësja për kompensimin e shpenzimeve të procedurës sipas tarifës së OAK-së dhe atë për përgjigje në padi si dhe për këtë seancë.

Andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas tarifës së OAK - së.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova:

Padia e datës 05.02.2015, fatura me nr. e dt..... vërejtja për pagesën e taksës gjyqësore me dt. 02.10.2018, fletëpagesa e dt. ..., aktvendimi për përgjigje në padi me nr. C.nr., i dt. 06.11.2019, aktvendimi për sigurim adrese me nr. C.nr.51/15 i dt.10.12.2020, parashtrësja e dt. 28.12.2020, procesverbali i dt. 26.10.2023, parashtrësja e dt. 21.10.2023 dhe provat, procesverbali i dt. 10.01.2024, kërkesë për sigurim e adresës Stacioni Policor në P... me 10.01.2024, përgjigja e stacionit policor në P... e dt. 15.01.2024, përgjigja në padi e dt. 02.04.2024, procesverbali i dt. 26.04.2024.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nuk është kontestuese se vepra penale për të cilën është ngritë propozim akuzë ndaj të paditurit ka ndodhur me datën 13.12.2008, e cila propozim akuzë në procedurën penale është hudhë dhe është pushuar procedura penale komform dispozitave ligjore të Kodit procedurës penale dhe Kodit penal për shkak të parashkrimit relativ të ndjekjes penale ndaj të pandehurit këtu të paditurit me aktvendimin P.nr.230/2011 të datës 20.01.2015 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, për veprën penale të Vjedhje nga neni 252 par 1. të KPK-së.

Kontestuese ishte fakti se paditësja a e ka parashtruar kërkesën e saj për kompensim dëmi i cili pretendon se i është shkaktuar me rastin e kryerjes së veprës penale datë 13.12.2008 nga ana e këtu të paditurit.

Gjykata, në kuptim të rrethanave të konstatuara më lart dhe duke e vlerësuar prapësimin e të paditurit përmes përgjigjes në padi dhe seanca në lidhje me parashkrimin e kërkesës për kompensimin e dëmit nga ana e paditëses, gjeti se kërkesa është e parashkruar.

Me dispozitën e nenit 377 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978) për kërkesat e natyrës së tillë është paraparë afati i parashkrimit ashtu që: *“Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”*, i cili afat në rastin konkret ka kaluar para se të jetë ngritur padia dhe atë nga data e ndodhjes së ngjarjes-kryerjes së veprës penale datë 13.12.2008 parashkrimi i ndjekjes penale ka arritur me datë 14.03.2014 me çka është parashkruar dhe kërkesa për shpërblimin e dëmit.

Po ashtu ne nenin 14 të Ligjit Nr. 03/L-006 të LPK – së thuhet se: *“ Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”* .

Pasi që u vërtetua kjo gjendje faktike padia dhe kërkesëpadia e palës paditëse u refuzua si e pabazuar, pasi që e njëjta u vërtetua se është e parashkruar dhe me këtë rast gjykata nuk u lëshua në vlerësimin e provave dhe pretendimeve tjera për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadiës.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është bazuar në dispozitat e neneve 449 dhe 450 të LPK-së, ashtu që gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga arsyet e cekura me lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.51/2015, me datën 25.06.2024**

Gjyqtari:
Binak Duqi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.